



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Datë 05/12/2024



PROCES VERBAL

Konsultimi Publik mbi ndërtimin e Zip Line

Vendi : Qendra Kulturore Multifunkionale

Ora : 12:30

Tema e konsultimit : Ndërtimi i Zip Line

I mbajtur sot më datë 5 Dhjetor në ambientet e Qendrës Kulturore Multifunkionale Përmet me pjesëmarrjen e Kryetares së Bashkisë, znj. Alma Hoxha, nën/Kryetares znj. Aulona Meshini dhe gjithë stafit drejtues të Bashkisë Përmet. Gjithashtu të pranishëm janë punonjës të AKZM Përmet, biznese dhe operatorë turistikë si dhe mjaft qytetarë të interesuar.

Takimin e hapi Kryetarja e Bashkisë e cila foli reth **15 minuta**. Si fillim ajo përshëndeti dhe falenderoi për kohën të gjithë të pranishmit në sallë. Më pas në vijim të fjalës së saj ajo theksoi se puna për të zhvilluar edhe më tej turizmin vazhdon duke e konsideruar një nga shtyllat e ekonomisë së qytetit. Gjithashtu ajo tha se ky projekt i ri është mjaft interesant dhe do të japi akoma dhe më shumë hov turizmit në qytetin e Përmetit.

Më pas fjalën e mori znj. Muraku e cila pergjatë **20 minutave** prezantoi më në detaje këtë projekt. Ajo u tha të pranishmëve se është dashur një kohë e gjatë për të vendosur mbi ndërtimin e këtij Zip Line pasi kanë shkelur thuajse cdo hapësirë përgjatë lumit Vjosa. Ajo u tha se është përzgjedhur një zonë e cila ka reth saj aktivitete të tjera turistike për të lidhur më pas me Zip Line. Në vijim të fjalës së saj ajo paraqiti gjithë idenë e funksionimit të këtij Zip Line për të qënë më e kuptueshme për të pranishmit në sallë.

Pas saj fjalën e mori kolegu z. Kurti i cili foli dhe shpjegoi pjesën tjetër të projektit për **20 minuta**. Ai u tha të pranishmëve se do të ndërtohet gjithashtu një Info Point për të ndihmuar gjithë turistët me informacionin e nevojshëm. Gjithashtu ai tregoi se zgjedhja e kësaj zone për ndërtimin e këtij Zip Line kishtë mjaft vështirësi pasi sic dihet me shpalljen e lumit Vjosa Park Kombëtar edhe ndërtimet përgjatë luginës janë të pamundura të ndodhin. Por nga ana e tyre është bërë një punë e madhe për të gjetur një zonë jashtë këtij perimetri.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Pas përfundimit të prezantimit nga ana e dy arkitektëve, ishte radha e të pranishmëve për të pyetur. Diskutimi vazhdoi **35 minuta** duke bërë që në fund të takimit të gjithë të jenë të qartë mbi atë cka pritet të ndodhi. Disa nga pyetjet që u drejtuan dy projektuesve ishin :

Si do të aksesohet ky Zip Line ?

Përse ata zgjodhën qytetin e Përmetit për realizimin e këtij projekti ?

Si do të zgjidhet problem i pronësisë pasi projekti do të ndërtohet edhe mbi pronë private ?

Pasi u dhanë përgjigje këtyre pyetjeve dhe shumë të tjerave takimi u mbyll në orën **14:00**.

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI PËRGJITHSHËM


Denisa DURO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Foto nga takimi:





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

